

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE (AKEP) PËR VITIN 2009

#### **Kuvendi i Shqipërisë:**

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm, rolin e AKEP-së në mbikëqyrjen e një prej tregjeve më dinamike dhe më të zhvilluara të ekonomisë së vendit, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin e konsumatorit shqiptar;

Duke njohur rolin e AKEP-së, si një autoritet rregullator i pavarur, transparent, i paanshëm, profesional dhe pararendës për tregjet e komunikimeve elektronike dhe postare;

Duke vlerësuar punën voluminoze dhe profesionale të AKEP-së në përgatitjen e analizave të tregjeve për telefoninë fikse, telefoninë e lëvizshme dhe të linjave me qera;

Duke vlerësuar transparencën e AKEP-së në lidhje me publikun dhe sipërmarrësit e ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit elektronik dhe postar, në punën e tij për realizimin e procesit të kalimit nga regjimi i licencimit në atë të autorizimit, i cili ka sjellë shumë lehtësi procedurale;

Duke njohur vështirësitë e fillimit të zbatimit të ligjit të ri, i cili ka sjellë një frymë të re në trajtimin e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare;

#### **Konstaton se AKEP-ja:**

- Ka ndikuar me punën e vet në reduktimin e tarifave të ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe postare;

- Ka realizuar legjislacionin rregullator për rregullat dhe caktimin e përdorimit të serive numerike;

- Ka realizuar transferimin dhe funksionimin e domain-it (ccTLD.al);

- Ka bërë një punë të mirë në lidhje me mbikëqyrjen e tarifave rekomanduese dhe marrëveshjeve të interkoneksionit dhe eksedit, si dhe në vlerësimin e Ofertave Referencë të Interkoneksionit të Operatorëve me Fuqi të Ndjeshme në Treg;

- Nuk ka realizuar disa nga detyrat e vendosura nga Kuvendi i Shqipërisë në rezolutat e mëparshme për vlerësimin e punës së ERT-së;

- Nuk ka bërë punë të mjaftueshme për hartimin e miratimit të legjislacionit rregullator, në përmbushje të detyrimeve ligjore në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë”, duke sjellë vonesa në rezultatet që priteshin nga ligji i ri;

- Ka shfaqur vonesa të pajustificueshme në vendimmarrje, si dhe në hartimin e rregullores për ndarjen e llogarive dhe kontabilitetin e kostove për operatorët e telefonisë celulare (BU-LRAIC) të shpallur OFNT, realizimi i së cilës do të ketë përfitime për konsumatorin;

- Nuk ka realizuar detyrimin për hartimin dhe miratimin e legjislacionit rregullator për sigurimin e portabilitetit të numrit dhe për hapjen e qarkut lokal;

- Nuk ka ndërmarrë asnjë hap konkret për realizimin e detyrimit për përmbushjen e shërbimit universal, si një mundësi për ofrimin e shërbimeve bazë, të përfshira në skemën e shërbimit universal dhe në zona ku këto shërbime mungojnë apo ofrohen në mënyrë të pamjaftueshme;

#### **Kërkon që AKEP-ja për vitin 2010:**

- Të forcojë pozitat e veta në rolin e autoritetit mbikëqyrës në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare;

- Të përshpejtojë punën për hartimin dhe miratimin e rregulloreve për procedurat dhe rregullat e funksionimit të njësive inspektuese dhe monitoruese të AKEP-së, si dhe ushtrimin e një veprimtarie inspektuese e monitoruese më të gjerë;

- Të angazhohet maksimalisht në përgatitjen e paketave rregullatore të pamiratuara akoma, në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare në

Republikën e Shqipërisë”;

- Të angazhohet në përgatitjen e dokumenteve rregullatore, për dhënien në përdorim të brezave të frekuencave që mbështesin teknologjinë UMTS dhe BWA (akses pa tel në brez të gjerë);

- Të angazhohet në përgatitjen e kuadrit të nevojshëm ligjor, për mundësimin e realizimit të shërbimit universal, si dhe në realizimin e zbatimit të portabilitetit të numrit;

- Të angazhohet maksimalisht në realizimin e në hartimin e rregullores për ndarjen e llogarive dhe kontabilitetin e kostove për operatorët e telefonisë fikse dhe asaj të lëvizshme.

6 maj 2010